

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo		
CAA		
Nr. i prot. 2025/ZDP/22 Er. prot./Prot. Nr.		
Faqe: 3 Stranica/Pages	Kopje: / Kopija/Copy	Data: 20/01/2025 Datum/Date
Hyrës/ulaznica..... Dakës/izlaza/out.....		<input type="checkbox"/>
Brendshëm/interio/interim.....		<input type="checkbox"/>
		Prishtinë/Prëftina/Pristina

01/ZDP/VE/2025  
Datë: 20 janar 2025

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1 (d) dhe (f), nenit 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në pajtim me Rregulloren (AAC) nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 (më tutje Rregullorja nr. 04/2011, e ndryshuar), Publikimin Teknik- TP-16 "Kriteret dhe procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë", Ver3 (më tutje TP 16),

Duke vepruar në bazë të kërkesës të subjektit afarist "Petrol Company" Sh.p.k, si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në ANP "Adem Jashari" për furnizim me derivate,

Pas pranimit të raporteve të vlerësimit dhe rekomandimeve nga njësitë përgjegjëse brenda AAC-së,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

## V E N D I M

- Aplikacioni i "Petrol Company" sh.p.k. me NRB 810527195, si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" për furnizim me derivate për kategorinë 7.1, përmbush pjesërisht kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren nr. 04/2011, të ndryshuar dhe Publikimin Teknik- TP-16 "Kriteret dhe procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë", Ver.3.
- Pas sigurimit të qasjes në treg (sigurimit të qasjes në infrastrukturë të centralizuar të aeroportit), subjekti nga pika 1 e këtij Vendimi duhet të ofroj në AAC dëshmi për përmbushjen e kërkesave në lidhje me kualifikimin e personelit, të ofroj policën adekuate së sigurimit, dhe duhet t'i nënshtrohet auditimit të përputhshmërisë në terren. Pas përmbushjes në tërësi të këtyre kërkesave, AAC mund të lëshojë Aprovimin përkatës.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Më datë 8 korrik 2024, "Petrol Company" sh.p.k., me NRB 810527195, ka aplikuar në Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) për miratim si furnizues i shërbimeve në tokë për palë të treta, për kategorinë 7 që përfshijnë Shërbimin me derivate dhe vajra për organizimin dhe ekzekutimin e operacioneve për

mbushje dhe zbrazje të derivateve, duke përfshirë deponimin e derivateve dhe kontrollin e cilësisë dhe sasisë të derivateve dhe furnizimin e vajrave e fluideve tjera.

Njësitë përkatëse brenda AAC-së, kanë vlerësuar dokumentacionin si vijon:

1. Aplikacionin e plotësuar dhe të dorëzuar në AAC;
2. Skemën organizative të kompanisë;
3. Pagesën e tarifës (50%);
4. Listën e personelit menaxhues dhe CV-të përkatëse;
5. Përshkrimin e përgjegjësive dhe detyrave për secilin rol;
6. Listën e pajisjeve aktuale në përdorim;
7. Kërkesat për trajnim dhe plani i trajnimeve (sillabusi);
8. Procedurat për menaxhimin e sigurisë;
9. Procedurat standarde për trajtimin e rrezikshmërisë;
10. Procedurat specifike të trajtimit për operatorët-klientë specifike;
11. Kërkesat për kualifikimin e personelit dhe trajnimet përkatëse;
12. Licenca për biznes në sektorin e naftës (import të kerozinës), lëshuar nga Ministria përgjegjëse;
13. Licenca për biznes në sektorin e naftës (deponim të kerozinës), lëshuar nga Ministria përgjegjëse;
14. Licenca për transport rrugor të mallrave të rrezikshëm, lëshuar nga Ministria përgjegjëse;
15. Certifikata e Biznesit;
16. Pasqyrat financiare për dy vitet e fundit financiare;
17. Raportet financiare të tremujorit të fundit mbi performancën e biznesit;
18. Informacione mbi besueshmërinë dhe aftësinë paguese të aplikuesit;
19. Dëshmi mbi pagesat e tatimeve;
20. Deklarata e auditorit mbi përmbushjen e kërkesës sipas nenit 4 të rregullores 04/2011 me ndryshime; dhe
21. Pronësinë e aplikuesit (dëshmia që tregon përfituesin përfundimtar).

Pas trajtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, njësitë përgjegjëse brenda AAC-së për shqyrtimin dhe verifikimin e aplikacioneve kanë konstatuar dhe rekomanduar se subjekti afarist "Petrol Company" sh.p.k., pjesërisht përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 10 të Rregullores Nr. 04/2011, të ndryshuar, dhe Publikimit Teknik TP-16 "Kriteret dhe procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë" (Ver. 3).

Nga dokumentacioni i paraqitur në AAC, është konstatuar se aplikuesi "Petrol Company" sh.p.k. nuk ka ofruar dëshmi për përmbushjen e kërkesave lidhur me kualifikimin e personelit, të përcaktuara në nenin 10.2 të Rregullores Nr. 04/2011, të ndryshuar, dhe në TP-16 (Ver. 3). Konkretisht, trajnimet e personelit operativ, përfshirë 'Aircraft Refuelling Certified Training' dhe 'Induction OJT Training,' nuk janë mbështetur me dokumentacion valid dhe të vlefshëm për ushtrimin e funksionit përkatës. Certifikatat e ofruara nga aplikuesi që datojnë nga viti 2013, nuk janë të vlefshme për ushtrimin aktual të funksionit përkatës. Aplikuesi nuk ka paraqitur planin e trajnimit për përtëritjen e certifikatave dhe kompetencës së personelit.

Aprovimi përfundimtar nga AAC për ofrimin e shërbimeve në tokë për kategorinë 7.1, sipas nenit 10 të Rregullores Nr. 04/2011, të ndryshuar, dhe TP-16, mund të jepet vetëm pas sigurimit të qasjes në treg (qasjes në infrastrukturën e centralizuar të aeroportit), pas ofrimit të dëshmive për kërkesat në lidhje me

kualifikimin e personelit, të ofrimit të policës adekuate të sigurimit dhe kryerjes së auditimit në terren për përputhshmërinë.

Polica e sigurimit, e cila duhet të dorëzohet, duhet të sigurojë mbrojtje nga rreziku për një periudhë prej së paku një viti. Kjo policë duhet të mbulojë përgjegjësinë e furnizuesit për dëmet që mund t'i shkaktohen një pale të tretë gjatë kryerjes së shërbimit, në një vlerë prej të paktën 250 milionë euro.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 14.1, 14.2, nenin 15.1 (d) dhe (f), nenin 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, të ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenin 24 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Rregulloren (AAC) nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, të ndryshuar, Publikimit Teknik- TP-16 “Kriteret dhe procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë” (Ver3) dhe raportet e vlerësimit të dokumentacionit dhe rekomandimet e njësive përkatëse në AAC, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

**Burim Dinavama**  
UD Drejtor i Përgjithshëm



Iu dërgohet:

- Petrol Company Sh.p.k., Prishtinë;
- Organit menaxhues të ANP “Adem Jashari” LKIA, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Komitetin për Partneritet Publiko Privat;
- Arkivit të AAC-së.